



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

## **AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS PARTNERITETI PUBLIKO – PRIVAT**



---

---

### **KËRKESË PËR KUALIFIKIM**

---

---

Komiteti Drejtues Ndërministror i Projektit (KDP), duke vepruar në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, fton për Kërkesë për Kualifikim (KpK) operatorët me përvojë në aeroporte, zhvilluesit dhe investitorët, për qëllime të operimit dhe zgjerimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (“Projekti”).

Ashtu si është parashikuar aktualisht, Projekti do të jetë marrëveshje 20 vjeçare e formës Dizajnim-ndërtim-financim-operim-transfer (DBFOT) dhe përmban me sa vijon:

- (i) Menaxhim, operim, dhe mirëmbajtje të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës; dhe
- (ii) Financim, projektim, prokurim dhe ndërtim të një programi për zgjerim të infrastrukturës, që përfshin ndërtesën e re referuese të terminalit, kullën e re të kontrollit dhe objektet përcjellëse, platforma të reja (apron) dhe taxi pista (taxiway), hapësirat e aeroportit ne anën tokësore.

Te gjithë ofertuesit potencial që do të kualifikohen në përputhje me kërkesat minimale të caktuara në Kërkesën për Kualifikim (KPK), do të ftohen që t’i dorëzojnë propozimet për Projektin.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) është një komponentë vitale e infrastrukturës së transportit të Kosovës dhe është një nga aeroportet më të ngarkuara në Ballkan, duke u shërbyer 1.2 milion pasagjerëve dhe duke zhvilluar 14,000 fluturime në vitin 2008. Në vitet e fundit, ANP ka mbajtur rritje të trafikut të pasagjerëve mbi shkallën mesatare, duke shënuar një rritje vjetore prej 11.4% në periudhën 2007-2008. Aeroporti aktualisht është fitimprurës, por Qeveria parashikon që një operator me përvojë do të jetë në gjendje të gjenerojë burime shtesë të të hyrave dhe do të përmirësojë nivelet e gjithmbarshme të operimit.

Qeveria fton të gjithë Ofertuesit e mundshëm që të dorëzojnë kredencialet e tyre deri më 23 shtator 2009, në përputhje me kërkesat për kualifikim, që mund të sigurohen në adresën e specifikuar më poshtë:

z. Osman Vishaj, Menaxher i Prokurimit  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Tel: + 381-38-200-34-013  
Faks: +381-38-213-143  
e-mail: [piaprocedurement@pppkosova.org](mailto:piaprocedurement@pppkosova.org)  
[www.pppkosova.org](http://www.pppkosova.org)